Project: Date ...../...../.....

# Protokoll Nr. 9

Ky protokoll mbahet sot me datë 26.09.2025, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë kati i dytë në godinën e Bashkisë për zhvillimin e mbledhjes se radhës për muajin Shtator 2025.

Në mbledhje morën pjesë këshilltarët:

Liri Biti Arduela Dodo Ngjazi Bollo
Alketa Gorica Jalgon Orapi
Shpëtim Sheshi Gjergji Teruti
Indrit Zyjoni Ajete Hebelli
Gëzim Apolli Astrit Derrasha
Elizabeta Rredhi, Ardjon Shurdhogi
Majlinda Xhaxo Eugen Veizaj
Sokol Kaloshi
Liri Biti Antuela Gjini

Meqenëse u plotësua kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, Sekretarja e Këshillit znj. Liri Biti e deklaroi mbledhjen të hapur:

Kalohet tek:

Rendi i ditës

1 - Miratimi i rendit të ditës
2 - Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 27.8.2025
3 - Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin gusht 2025.
4 - Projektvendim për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok ndihmen për muajin gusht 2025.
5 - Projektvendim mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme
6 - Projektvendim për miratimin e Programit buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Divjakë për vitet 2026-2028 faza e dytë.
7 - Projektvendim për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.

1 - Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës.

Sekretarja i drejtohet këshilltarëve

Project: Date ...... / ...... / ...23..

A kemi pyetje apo diskutime për rendin e ditës?
Merr fjalën Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë z. Indrit Zgjana, ku propozon shtesa në rendin e ditës.
1- Projektvendimi Nr 64 prot me nr 9742/14 date 22.09.2025 " Për anullimin e VKB nr 56 dt. 27.8.2025 " Për përditësimin e pozicionit me nr 15 të listës së inventarit të pronave të kaluara në pronësi/përdorim të Bashkisë Divjakë me VKM nr 499 dt. 19.7.2006.
2- Projektvendimi Nr. 65 prot. me nr 9742/16 date 22.9.2025 " Për përditësimin e pozicionit me nr 15 të listës së inventarit të pronave të kaluara në pronësi/përdorim të Bashkisë Divjakë me VKM Nr. 499 dt. 19.7.2006.
3- Projekt vendimi nr 66 prot. me nr 9742/18 date 23.09.2025 " Për anullim të VKB nr 53 date 27.08.2025 " Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për vitin 2025-2029.
4- Projektvendimi Nr. 67 prot. me nr 9742/21 date 26.09.2025 " Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në Buxhetin e vitit 2025.
Kryetarja i drejtohet këshilltarëve: A kemi pyetje apo diskutime për propozimin për shtesat në rendin e ditës?
Relatori këshilltari z. Ardjan Shurdhogi duke u shprehur se nuk duhet të kemi shtesa në rendin e ditës.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, 2 vota abstenim dhe asnjë votë kundër së bashku me shtesat.
2- Pika e dytë e rendit të ditës.
- Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua me date 27.8.2025.
Pyetje rreth procesverbalit s'ka, diskutime

Project: Date ...... /...... / ..........

rendit të ditës dhe votohet me 18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3- Pika e tretë e rendit të ditës
- Informacion mbi zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin gusht 2025.

Sekretarja z.j. Adin Biti e drejtohet këshilltarëve: Informacionin e keni lexuar dhe po ju pyes: A kemi pyetje apo diskutime rreth këtij informacioni.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Atëherë kalojmë tek Raporti i Komisionit të ekonomisë dhe financave. Fjalën ia jep z. Gerti Agolli.

z. Gerti Agolli lexon Raportin e komisionit të ekonomisë dhe financave i cili është mbajtur me datë 24.09.2025, dhe shprehet se të katër projekt vendimet e paraqitura nga Bashkia, pasi u shqyrtuan nga Komisioni u vendos që të kalojnë për miratim.

4- Pika e katërt e rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok ndihmën për muajin gusht 2025.

Për këtë projektvendim relatori Përgjegjësi i Sektorit të mirëqenies sociale dhe punësimit shoqëror z. Ledio Muço, ku i propozon KB të miratojë familjet në nevojë të dala nga sistemi i pikëzimit me pikët e mjaftueshme dhe që kanë aplikuar, pasi u është bërë dhe verifikimi në familje, të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar për muajin gusht 15 familje me një fond prej 72841 lekë.

Këto familje janë: Elisabeta Zeri 10692 lekë, Afërdita Zeqo 5940 lekë, Esmeralda Gjata 7920 lekë, Vitrina Sula 5940 lekë, Ymer Alhajrani 1525 lekë, Ehrem Aliumi 2178 lekë, Evanthi Neko 5940 lekë, Alketa Meta 9504 lekë,

Asllan Proshena 4752 lekë, Mimoza Kros-
-niqi 2178 lekë, Zef Kolndreu 4752 lekë
Bashime Gjini 1525 lekë, Donika Sina
3146 lekë, Zegir Zegiri 3703 lekë
Fatime Gere 3146 lekë.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit
të ditës dhe votohet me 18 vota pro,
asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

5- Pika e pestë e rendit të ditës
Mbi miratimin për familjet në nevojë për
dhënien e ndihmës financiare të menjëher-
-shme.
Për këtë pikë relaton z. Dedio Muça
ku përshkruan gjendjen ekonomike tejet
të vështirë të familjes së z. Astrit Meh-
-meti, si dhe nga ana shëndetësore që
vuan, banor i fshatit Grabjan dhe i
propozon këshilltorëve që të miratojnë
një ndihmë të menjëhershme prej 60.000
lekë i cili do të përballohet nga buxheti
i vitit 2025 nga zëri të tjera.
Për këtë familje sqaron dhe Kryetari
i Bashkisë duke shprehur që të ndih-
-mojmë këtë familje menjëherë se është
në kushte të vështira ekonomike.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit
të ditës dhe votohet me 18 vota pro
asnjë votë kundër dhe asnjë votë abste-
-nim.

6 - Pika e gjashtë e rendit të ditës
- Për miratimin e PBA të Bashkisë
Divjakë 2026-2028 faza e dytë.
Kryetarja znj. Dritë Bizi i a jep fjalën
për relatim Drejtorit të financës dhe
Buxhetit z. Xhelodin Bashkola, ku:
Lexon relacionin dhe i propozon këshilltorëve
të miratojnë PBA 2026-2028 fazën e dytë

Project: Date ...... /...... / ..........

me këto parashikime të ardhurash dhe shpenzimesh.

I - Parashikimi i të ardhurave. në lekë

| Burimet buxhetore | 2026 | 2027 | 2028. |
| --- | --- | --- | --- |
| Të trashëg nga v. kaluar | 61.701 644 | 47 975 000 | 45 090 000. |
| Të ardh. nga bur. everta | 211 864 000 | 219 064 000 | 223 000 000 |
| Transf. e pakushtëz. | 307 683 973 | 318 346 488 | 328 795.851 |
| Niveli i Tprogebe | 41 043 007 | 41 043 007 | 41 043 007. |
| Transf. pakusht. sekt. | 167 078 102 | 167 078 102 | 167 078 102. |
| Totali | 789.320.726 | 793.506.597. | 805.006.960 |
| Projekti Joinable f.h. | 3 851 578 | 3 538 362. | 0 |
| Shuma | 793.172.304. | 797.044 959, | 805.006.960 |
| Transf. e kushtëz. | 278.300 000 | 288.600.000 | 288 600 000 |
| Totali i të ardh. | 1071 472 304 | 1085 644 959 | 1093 606 960. |
| Shpenzimet e Nj. Q.V. | | | |
| - Bashkia Dibër | 686,760,532 | 690.633,187. | 698 595 188 |
| - Agjencia e Sh. kom. | 106.411.772 | 106 411 772 | 106 411 772 |
| Totali | 793.172.304 | 797.044.959. | 805.006 960. |

Planifikimi dhe përgatitja e PBA 2026-2028 shprehet Drejtori i financës dhe buxhetit është përgjegjësi e të gjithë drejtorive dhe sektoreve në Bashki.
Kryetarja i drejtohet këshilltarëve:
A keni pyetje apo diskutime për pikën e 6 të rendit të ditës?
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vote pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
7 - Pika e shtatë e rendit të ditës
- Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.
Për këtë pikë relatoi Drejtori i financës dhe Buxhetit Z. Xheladin Bushkola, ku i propozoi këshilltarëve të miratojnë një rishpërndarje fondesh nga programi 09120 arsimi parashkollor programi 04520 rrugët rurale, zëri tjetër 602, programi 01110 investime llog. 231 ku të pakësohen këto fonde në total 15,945,560 lekë dhe të shtohen fondet si shtesë sipas projektit për investimin

- Linja e kanalizimeve të ujrave të zeza dhe shtes impianti për trajtimin e ujrave të zeza. Divjakë për vlerën 14.925.560 lekë.
- Mbikqyrje punimesh për investimin Linja e KUZ dhe shtes impianti Divjakë 900.000 lekë.
- Kolaudim punimesh në linjen KUZ për vl. 120000 lekë.

Ky investim shprehet ai, është shumë i rëndësishëm për nga situata aktuale të ujrave të zeza në qytetin Divjakë pasi tek pallatet e vjetra të qytetit ujrat e zeza kanë dalë në sipërfaqe dhe po bëhen burim sëmundjesh dhe epidemish.
Kryetarja znj. Lili Bita: A keni pyetje?
z. Eugen Vendhe: A është përllogaritur mirë shuma e fondit se më del 35 milion.
Përgjigjet z. Xhelalin Brahkolo: Të gjitha llogaritjet si shtesat dhe paksimet janë në rregull.
Diskutoi Kryetari i Bashkisë rreth këtij projekt vendimi dhe sqaroi fondet sipas zërave ku do të paksohen dhe do të shtohen tek Linja KUZ Divjakë.
Diskutoi z. Eugen Vendhe duke u shprehur se ka planifikuar qeveria fonde për linjat e KUZ dhe mendoj që nga ana e Bashkisë të bëhet një përllogaritje e mirë për pastrimin e tubacioneve dhe KUZ, mbase na duhet një fond më i vogël.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Këtë propozim e kemi në mënyrë emergjente, dhe nëse na sjell qeveria fonde do kemi më mirë.
z. Gojët Abdli: Po fondi për investime për këndet e lojrave a do të planifikohet në buxhetin e v. 2026?
Përgjigjet Kryetari: Po, do të përfshihet në vitin 2026.
z. Lili Bita: Mendoj që vetë biznesi ti heqin ujrat e zeza dhe të bardha, dhe ju si kryetar duhet ti detyroni, ose

Project: Date ...... /...... / ..........

të ndërprisni ujin e pijshëm.
Kryetari z. Josif Gorrea: Do mundohemi
që të bashkëpunojmë me bizneset e këtyre
pallateve dhe besoj se do të zgjidhet ky
problem sa më shpejt.
z. Eugen Vendhe: A ka leje shfrytëzimi
pallati, si punon biznesi pa certifikatë
pronësie?
Tjetër të tjerë s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtuar e rendit të
ditës dhe votohet me 16 votë pro, 1
votë kundër dhe 1 votë abstenim.
8- Pika 8 (shtesë) e rendit të ditës
- Për anullim të VKB nr 56 datë 27.8.2025
Për përditësimin e pasurisë me nr 15 të listës
së inventarit të pronave të kaluara në pronësi
/ përdorim Bashkisë Divjakë me VKM nr 477
datë 19.7.2006.
Kryetarja ia jep fjalën për relatim z.
Andi Bullari: Kili i propozon këshi-
llit anullimin e VKB nr 56/datë 27.8.
2025 për arsye të disa parregullsive gjatë
verifikimit të ligjshmërisë nga Prefektura e
Qarkut Fier.
Tjetër: z. Astrit Dervishi: Mendoj se
nuk duhet të shprehemi me anullim por
me shfuqizim të VKB. Gjithashtu duhet të
shikoj ligjin 44/2015 "Kodin e procedurave
administrative.
z. Ardian Vodo: Mendoj se duhet të
sqarohemi nga ana ligjore për anullimin e
këtij vendimi.
z. Eugen Vendhe: E gjithë kjo pronë është
në pronësi apo ka dhe në përdorim.
z. Ardian Vodo: Duhet të vij Dr. Pl. Zhv.
Territorit që të na japë sqarimet e nevoj-
shme mbi këtë pronë.
z. Eugen Vendhe: Do hyjë do të jetë
Përgjigjet Kryetari: Do do të jetë.

PUBLIKA E SHQIPERIS

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Ata dhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë kundër dhe 2 vota abstenim.
9- Pika e nëntë e rendit të ditës. (shtesa)
- Për përditësimin e pasurisë me nr 15 të listës së inventarit të pronave të kaluara në pronësi/përdorim të Bashkisë Divjakë me VKM nr 499 datë 19.07.2006.
Për këtë pikë relatoi juristi i Bashkisë, Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe prokurimeve publike si dhe menaxhimit të aseteve z. Andi Bullari, i cili i propozon këshilltorëve që të miratojnë përditësimin e pasurisë me nr 15 të listës së inventarit të pronave të kaluara në pronësi/përdorim sipas VKM nr 499 dt. 19.7.2006 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Divjakë të Qarkut Fier. Kjo pasuri me nr 643/12 e llojit Terren sportiv, me vol 36 fq 223 në ZK 1492 me sipërfaqe 21120 m² dhe është pronë shtet. I gjithë dokumentacioni është bashkangjitur relacionit dhe VKM nr 499 dt. 19.7.2006.
Kryetarja znj. Diri Biti pyet këshilltorët:
A keni pyetje apo diskutime?
Pyetje z. Eugen Vendha: Nga këto 108 prona që ka ky vendimi sa janë me certifikat pronësie, sa prona janë në proçes certifikimi dhe sa prona nuk janë të regjistruara.
Përgjigjet Kryetari: Kemi regjistruar disa prona, vazhdon proçesi i certifikimit dhe mendoj se rreth 10 % të pronave i kemi certifikuar.
Pyetje z. Eugen Vendha: Sa prona shtet ka Bashkia Divjakë.
Përgjigjet Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xhelaldin Brahkola
Në mbledhjen e muajit Gusht e kemi informuar Këshillin Bashkiak për çdo pronë të Bashkisë Divjakë sipas gjendjes aktuale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIVJAKË SEKRETARI

Project: Date ...... / ...... / ..........

Pyetje të tjera s'ka diskutime s'ka.
Hedhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës
dhe votohet me 17 vota pro, 1 votë kundër
dhe asnjë votë abstenim.

10 - Pika e dhjetë shtesë në rendin e ditës.
Për anullim të Vendimit të Këshillit
Bashkiak Nr 53 datë 27.8.2025 "Për miratimin e Planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për vitin 2025-2029."
Kryetarja znj. Dini Biti i jep fjalën z. Andi Balloni që të relatoj mbi këtë projekt vendim. z. Andi Balloni i propozoi këshilltarëve anullimin e VKB nr 53 datë 27.8.2025 duke sqaruar arsyet e anullimit: Për këtë Vendim gjatë verifikimit të ligjshmërisë nga Prefektura jemi konstatuar disa parregullsi: Nga ana jonë nuk është marrë Deklarata e Ministrit për Vlerësimin strategjik mjedisor i cili duhej përfshirë në këtë plan, Nuk jemi mbështetur tek ligji 91/2013 "Për Vlerësimin strategjik mjedisor, dhe si Agjensi e Shërbimeve komunale nuk kemi sqaruar, zbatimin e procedurës të parashikuar nga ky ligj. dhe nuk i jemi shprehur Prefekturës nëse e kemi marrë Deklaratën e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit i cili është kusht i domosdoshëm për marrjen në shqyrtim për miratim nga autoriteti miratues.
Znj. Dini Biti: A kemi pyetje apo diskutime?
z. Ardian Vodo: Na sqaroni në çfarë jemi?
Vetëm do të bëjmë anullimin e këtij vendimi apo kemi hartuar projekt vendim për të miratuar.
Përgjigjet z. Andi Balloni: Jo, vetëm kërkojmë anullimin e VKB nr 53 dt 27.8.2025.
z. Ardjan Shurdhaqi: Të shikohet nga ana ligjore ky Vendim anullohet apo shfuqizohet.
dhe mendoj se ky Vendim është anulluar vetëm se nuk kemi marrë Deklaratën "Për vlerësimin strategjik mjedisor nga Ministria e Turizmit

dhe Mjedisit.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dhjetë shtesë në rendin e ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë shtesë në rendin e ditës. Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.
Relatori Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Skelqim Brahkola, i cili i propozon këshilltarëve të miratojnë një rishpërndarje fondesh në buxhetin e Bashkisë Divjakë nga Programi 01110 "Planifikim, menaxhim, administrim nga zëri të tjera në zërin "investime" llog. 231, progr. 04130 si:
Të pakësohen fondet në vlerën 1.678.950 lekë dhe të shtohen fondet në programin "Mbështetje e zhvillimit ekonomik në vlerën 1.201.950 lekë, ku do të shtohet projektit "Breg peshku në lagunën e Karavastas, në zonën e Rezit, në kanalin e Vaut. Vlera prej 432000 lekë do të përdoret për mbikqyrjen e këtij projekti
Vlera prej 54.000 lekë do të përdoret për kolaudimin e këtij projekti
Vlera fillestare e projektit "Breg peshku në lagunën e Karavastas në zonën e "Rezit, në kanalin e Vaut Bashkia Divjakë" ishte 29.993.000 lekë dhe me shtesën prej 1.201.950 lekë, vlera e këtij investimi do të shkojë 31.194.950 lekë. Fondet që do të përdoren për shtesën e këtij projekti do të merren nga zëri të tjera programi 01110 kap. 01, llog. 602
Në zërin të tjera në Buxhetin e vitit 2025 janë planifikuar 5.000.000 lekë nga të cilat ngelen ende të papërdorura vlera prej: 1.359.829 lekë.
Kryetarja znj. Lin Biti: A keni pyetje apo diskutime për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:
z. Lili Biti: Me sa di unë ky aktivitet ka dal me humbje. A keni bërë projekt tjetër?

Project: Date ...... /...... / ..........

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea:
Po kemi bërë projekt tjetër të cilin e kemi dërguar.
Çështje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë shtesë në rendin e ditës dhe votohet me 18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
Kryetarja zj. Xin Bizi i drejtohet këshilltarëve:
Tani kalojmë në pikën e fundit të mbledhjes tek - Të tjera:
Znj. Alketa Cenaku: Në grabjan është një femij që ka nevojë për karrocë se është invalid. E quajnë Elton Zhepa.
Përgjigjet Drejtuesi i Sektorit të Mirëqenies Sociale dhe përkujdesit shoqëror z. Dedio Muço.
Po, do interesohemi dhe do t'ja sjellim.
z. Ngeri Bollo: Fusha e sportit në Cerrie Sektori a do të vazhdojnë punimet, rrethimi a do të bëhet?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë duke e sqaruar se do të vazhdojnë me punimet si dhe me ndriçimin.
z. Ardjan Shurdhaqi: Po tek fusha e sportit në grabjan a do të vazhdojnë punimet, ka nevojë dhe për porta.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë, Po edhe në grabjan do të vazhdoj investimi në fushën e sportit.
z. Xhorxhi Kraiti: A po punojnë mjetet që kemi blerë për shtrimin e rrugëve se nuk po shikojmë punime të përfunduara.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë:
Po shtrojmë rrugët me asfalt sidomos këtu në Divjakë tek ish stallat e lopëve.
z. Xhorxhi Kraiti: Po dhotë fjalën për aktivin e një vendi ku të grumbullohen plasmaset e ziut. Akoma nuk e kemi caktuar?
Hidhen shumë mbetje plastike ku kanë bllokuar kanalet dhe janë përhapur gjithandej.

Drejtuesi Kryetari i Bashkisë: Edhe këtë problem do ta shikojmë dhe them se do rregullohet.
2. Ardian Vodo: Në kryekup kemi shumë problema. Ika në drejtim të qytetarëve që vijnë me kartela në duar për vizita. A është mundësia që të caktohet një doktor për në Kryekup se ne si qendër nuk po i plotësojmë dot. Banorëve të Kryekupit nuk po i jepet shërbimi shëndetësor.
- Për shkollat kam problematikë se nuk furnizohen me detergjent dhe kushtet higjenike janë për tu dëshiruar. A keni projekt për furnizimin e shkollave me detergjent pastrimi.
- Në Ambulancën e fshatit Xeng nuk ka një llambë ndriçimi, duhet të vendoset ndriçimi se është e domosdoshme.
- Në qendër të Divjakës duhen projektuar banjo publike, se ka shumë pensionistë që tërheqin pensionet tek banka dhe tek posta, për të kryer nevojat personale.
2. Eugen Vendha: Kam vënë re që transmetimet e mbledhjeve të KB nuk janë shumë të mira, janë plot zhurmë e nuk dëgjohen.
Drejtuesi Kryetari: Do ta rregullojmë këtë problem.
- Ka dy muaj që montohen shtylla për internetin. A ka projekt të miratuar nga Bashkia? Duhet të marin miratim nga Kryetari i Bashkisë.
- U përmend faza e dytë e projektit për ujitje me pika. Çfarë do bëhet, a është funksionant, duhet të bëhet analiza e ujit dhe pastaj vendoset se ky projekt a funksionon apo ka dalë jashtë loje.
Drejtuesi Kryetari i Bashkisë: Do mundohemi të bëjmë më të mirën, por e di që cilësia e ujit është shumë e keqe dhe nuk duhet të përd. për vaditje.
2. Eugen Vendha: Në lidhje me koshat e plehrave. I shikoj që janë gjithnjë plot. A ka ardhur koha që t'ja japim privatit këtë shërbim?
2. Eugen Vendha: Po për shpronësimin e pronave si kanë filluar në prokurim publik?
Drejtuesi Kryetari i Bashkisë për të pyetje dhe

Project: Date ...... / ...... / ...........

për VKM për shpronësim thot ai, i kemi mohuar qytetarët sipas listës, sepse nuk duam të dijen fondet për shpronësim që këto prona të kalojnë në shtet.
Dyfje dhe diskutime të tjera s'ka.
Kryetarja znj Lini Bili e deklaron mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Divjakë për m. Shtator të mbyllur.

Sekretari i KB.
Mimoza Gjomaj

Kryetari i KB.
Lini Bili

Indrit Gjoma
Gjon Agolli
Sh. Meshi
Alketa Canaj
Ajete Mesalli
Xhoshi Kruti
Njazi Ballavaku
Lini Bili
Julian Vrapi
Elizabeta Kreolli
Majlinda Xhara
Sokol Kaloshi
Antuela Gjini
Engjell Verdha